

Data 30.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje 50 karroca për fshesar”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.406.700 (Nje milion e katerqind e gjashte mije e shtateqind) Lek pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285 (i ndryshuar) , datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kerkesat e mesiperme jane detyruese dhe i sherbejne Autoritetit Kontraktor per te krijuar bindjen e tij se operatoret ekonomik pjesemarres ushtrojne veprimtarine e tyre konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi, permbushin kriteret ligjore per te marre pjese ne procedura prokurimi si dhe kane shlyer te gjitha detyrimet sipas percaktimeve te legjislacionit perkates.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi, si nje mjet garancie per Autoritetin Kontraktor ne rast te tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë elektronikisht Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të LPP, si dhe nenit 22 të ligjit nr. 16 dt.08.02.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik". (i ndryshuar)

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2023- 2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 2 germa c) dhe pika 3 të VKM nr. 285 (i ndryshuar), datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285 (i ndryshuar), datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e vlerës është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 2 germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285 (i ndryshuar), datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe është bërë bazuar në Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.26/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 55, pika 4, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.4 Kërkesa të vecanta:

2.4.1. Ofertuesi në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostren pranë Autoritetit Kontraktor. Produkti për të cilin kërkohet të paraqitet mostra është i renditur në Shtojcën 7.

Mostra e kërkuar duhet të ketë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë emërtimin: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Mostra duhet të jetë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në SPE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të LPP nr 162 datë 23.12.2020 (Për Prokurimin Publik), si dhe nenit 22 të ligjit nr. 16 dt.08.02.2024 “Për disa shtesa dhe

ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. (i ndryshuar) dhe VKM nr 285/2021 e perditesuar neni 40 pika 6 dhe 8, Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Eco Tirana sh.a. mbi kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij në përputhje të plotë me kuadrin ligjor.

SPECIFIKIMET TEKNIKE Objekti: “Blerje 50 karroca për fshesar”

Karroca dore Karroca duhet të jetë e re, e papërdorur dhe të plotësojë specifikimet minimale të mëposhtme:

Të jetë e ndërtuar me **konstrukcion tubolar çeliku**, i realizuar me **lakim në të ftohtë**, me rezistencë të lartë mekanike.

Të jetë e trajtuar kundër korrozionit dhe e lyer me **bojë pluhur poliesteri** me pjekje në furrë.

Ngjyra: Portokalli RAL 2002.

Të jetë e pajisur me **2 rrota gome të ngurta**, me përmasa **600 × 27.5 mm**, të montuara në **kushineta topash (ball bearings)**, për lëvizje të lehtë dhe jetëgjatësi.

Të jetë projektuar për mbajtjen e **2 koshave plastikë cilindrikë me kapacitet 100 litra secili**.

Në pjesën anësore të ketë:

1 mbajtëse për fshesën;

1 mbajtëse për tehun/lopatëzën e pastrimit.

Midis pozicioneve të dy bidonëve të ketë një **depozitë metalike** për vendosjen e mjeteve të punës ose materialeve ndihmëse.

Të jetë e pajisur me **dy doreza ergonomike** për shtytje manuale, të përshtatshme për përdorim të vazhdueshëm.

Të ketë **dy pika mbështetëse** në pjesën e dorezave, në mënyrë që kur karroca nuk është në lëvizje të qëndrojë në mënyrë të qëndrueshme mbi dy rrotat dhe dy mbështetëset.

Konstrukti duhet të garantojë stabilitet gjatë transportit dhe përdorimit në ambiente urbane.

Të gjitha elementet metalike duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike.

Kërkesa të përgjithshme Të gjitha pajisjet duhet të jenë **të reja**, të papërdorura dhe të prodhuara sipas standardeve të cilësisë. Produkti duhet të jetë pa defekte prodhimi dhe i gatshëm për përdorim. Furnitori duhet të garantojë përputhshmërinë e plotë me specifikimet teknike të kërkuara. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë përputhshmërinë e produktit me specifikimet gjatë dorëzimit.

Dorëzimi Karrocat duhet të dorëzohen të montuara dhe të gatshme për përdorim.

Vendi i dorëzimit: Eco Tirana Sh.a. Ish Parku i Autobusave, Don Bosko, Tiranë. Brenda dates 30.09.2026